



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 521/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Z. Vedat Poterqoi- Kryetar, Znj. Kimete Gashi– Referuese, Z. Agon Ramadani-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "Teuta M", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Kanalizimi Fekal Livoç i Epërm – Livoçi i ulët dhe një pjesë e lagjes Kodra e Thatë", me nr.të prokurimit: 651-22-6403-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjilan, me datën 01.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "Teuta M", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 07.10.2022 me numër të protokollit 521/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Kanalizimi Fekal Livoç i Epërm – Livoçi i ulët dhe një pjesë e lagjes Kodra e Thatë", me nr.të prokurimit: 651-22-6403-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjilan, kurse Vendimi i AK i datës 20.09.2022, për dhënie të kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit, **Vertetohet**.

II. Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuara në emër të tarifës për ankesë të OE "Teuta M" kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

A r s y e t i m

Me 29.06.2022, Autoriteti Kontraktues - KK Gjilan ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Kanalizimi Fekal Livoç i Epërm – Livoçi i ulët dhe një pjesë e lagjes Kodra e Thatë", me nr.të prokurimit: 651-22-6403-5-2-1.

Me datën 20. 09. 2022, AK - Komuna Gjilan ka publikuar vendimin mbi dhënien e kontratës sa i përket aktivitetit të prokurimit, ndaj të cilit OE “Teuta M” me 26.09.2022, ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK me vendim të datës 29.09.2022.

Me 07.10.2022 OE “Teuta M”, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokolli: 521/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin teknik të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti teknik ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 31.10.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE të refuzohet si e pa bazuar;
- Të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimet ankimore

Pas analizimit të ankesës dhe pretendimeve ankimore, pavarësisht numërimit të 13 pretendimeve ankimore, kemi gjetur se ankesa bazohet në tri çështje/probleme kryesore:

Qasja në dokumente zyrtare; Përgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë; klasifikimi i AK-së për Konflikt të interesit për OE ankues.

Pretendimi nr.1

OE ankues pretendon se i është kufizuar qasja në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë, duke pretenduar se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar si duhet kërkesën për sekret afarist dhe se dokumentet publike nuk mund të jenë sekret afarist.

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, kemi gjetur se i njëjti në formularin e dorëzimit të ofertës ka plotësuar kërkesën për sekret afarist.

Eksperti shqyrtues pajtohet me konstatimet e OE ankues se dokumentet publike, siç janë kontratat me autoritete kontraktuese janë kontrata publike dhe nuk mund të konsiderohen si sekret afarist.

OE ankues në mungesë të qasjes së plotë në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë ka ngritur dyshimet e veta se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket referencave, stafit, si dhe konteston formën e noterizimit të pajisjeve të ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Pretendimi nr.2

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Më konkretisht OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk plotëson kërkesat për referenca për punë të ngjashme, nuk plotëson kërkesat për stafin, si dhe konteston noterizimin e makinerisë.

Në cilësi të ekspertit shqyrtues konsiderojmë se nuk kemi autorizim të bëjmë publike dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë të cilat i njëjti i ka klasifikuar si sekret afarist, me gjithë këtë me qëllim të shqyrtimit të ankesës dhe me qëllim për tu përgjigjur në pretendime ankimore, kemi analizuar me kujdes ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe vlerësojmë se OE i rekomanduar për kontratë plotëson kërkesat e dosjes si për referenca në tri vitet e fundit, njëjtë ashtu edhe sa i përket kualifikimit dhe përvojës së stafit.

Dëshmitë lidhur me këto pretendime nuk mund ti bashkëngjisim në ekspertizë për arsyet e cekura më lart, me gjithë këtë të njëjtat dëshmi mund i ofrojmë për panelin shqyrtues.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë e ka listën e pajisjeve të noterizuar sipas kërkesës së AK-së, dhe nuk ka qenë kërkesë që lista pajisjeve të noterizohet veçanërisht për këtë aktivitet të prokurimit siç pretendon OE ankues.

Bazuar në këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimet ankimore se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket referencave, punëtorëve dhe pajisjeve janë të pabazuara.

Pretendimi nr.3

Pretendimi i radhës (dhe kryesor) ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së ky OE i ka dy punëtorë, konkretisht z.Terstena dhe z.Xhelili të emëruar pranë Komunës së Gjilanit në cilësi të Organit mbikqyrës për dy kontrata të kësaj komune.

Ne gjatë analizimit të shkresave të lëndës në pamundësi për të gjetur dëshmi lidhur me këtë qështje kemi kërkuar sqarime shtesë nga AK-KK Gjilan dhe me 25.10.2022 kemi pranuar dy vendime përmes të cilave z.Feriz Terstëna është emëruar si organ mbikqyrës për kontratën “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Llashicë”, ndërsa z.Xhafer Xhelili është i emëruar si organ mbikqyrës për kontratën “Asfaltimi i rrugëve në lagjen Arbëria”.

Provë : Vendimi për emrimin e Menaxherit të projektit dhe Organit mbikqyrës nr.1055(Xhafer Xhelili).

Provë : Vendimi për emrimin e Menaxherit të projektit dhe Organit mbikqyrës nr.963 (Feriz Terstëna).

Vlen të ceket se z.Terstëna (pjesë e stafit të OE ankues) është i emëruar organ mbikqyrës për një kontratë ku i kontraktuar është OE tjetër pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit kompania Company Zuka Comerec.

Nga rrethanat e përshkruara më lart, rezulton që (z.Terstëna) pjesë e OE ankues është organ mbikqyrës i një kontrate të nënshkruar nga OE tani konkurrent në këtë aktivitet të prokurimit.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se ekziston rrethana e paraparë me nenin 6 të ligjit Nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të mbetet në fuqi vendimi AK-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE ankues nuk është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues. Përderisa AK është pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me datën 24.11.2022 u mbajt seanca e shqyrtimit kryesor në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i EO ankues, përfaqësuesi i AK si dhe eksperti shqyrtues.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Duke i analizuar në tërësi shkresat e kësaj lënde, para shkresat dhe veprimet ndërmerrura nga palët, Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se tenderët se pari duhet të jenë të përgjegjshëm në kuptimin administrativ, siç thuhet në nenin 27 të LPP, duke përfshirë mes tjerash të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj. Gjatë analizimit dhe krahasimit të provave në dispozicion, Paneli konsideron se, pavarësisht akteve dhe veprimeve të AK, megjithatë gjetjet dhe konstatimet të cilat janë evidentuar në raportin e ekspertit shqyrtues nuk mund të kontestohen. Paneli vërejtë se, Raporti i ekspertit është përpiluar në mënyrë profesionale, përfshinë të gjitha pohimet ankimore dhe përmban të gjitha elementet qenësore të ekspertizës, sikurse kërkohen ato në kuptim të nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP. Gjithashtu, në lidhje me pretendimet tjera të paraqitura në ankesë, Paneli Shqyrtues mbështet sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues të paraqitura në raportin e cituar si më sipër.

Për çështjen e konfliktit të interesit të cilin OE e ka ngritur, PSH i morri në konsiderate edhe rrethanat dhe faktet e dorëzuara nga AK dhe OE lidhur me këta dy inxhinierë të cilët përveç angazhimit të tyre si profesorë në institucione arsimore, ata janë të angazhuar edhe me detyra dhe përgjegjësi shtesë edhe nga autoriteti kontraktues Komuna Gjilan për vlerësimin e ofertave dhe mbikëqyrjen e kontratave të kësaj Komune. Duke pasur parasysh këto angazhime të tyre, PSH merr në konsideratë edhe një OPINION të lëshuar nga Agjencioni Kundër Korrupsion me të cilin përveç që bënë interpretimin e dispozitave që trajtojnë konfliktin e interesit, ata shtrojnë edhe pyetje se si është e mundur që një person brenda një orari të rregullt të punës, të angazhohet njëkohësisht në disa vende pune me po atë orar.

Për më tepër angazhimi i tyre në Komunën e Gjilanit duke ushtruar detyra zyrtare si organ mbikëqyrës dhe komision vlerësues si dhe në të njëjtën kohë angazhimi i tyre në anën e OE si ofertues në një aktivitet të prokurimit të cilën e ushtron po kjo komunë, PSH këtë rrethanë e konsideron se është në kundërshtim me Ligjin e Konfliktit të Interesit. Po ashtu do të krijonte mundësi eventuale të rrjedhës së informacionit dhe keqpërdorimit të tyre që bien ndesh edhe me dispozitat e LPP-së dhe Kodin Etik të Prokurimit.

PSH nuk e mohon faktin se në të kaluarën ka pasur angazhime të tilla të këtyre inxhinierëve në kësaj forma, por është përgjegjësi e AK-së të ndërmerr veprime dhe masa ndaj këtyre rasteve sepse përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore.

- Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret. Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa e operatorit ekonomik “Teuta M”, e ushtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, nuk përmban prova jo kontestuese për ti vertetuar pohimet e theksuara në ankesë. Andaj Vendimi i AK i datës 20.09.2022, për dhënie të kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit, është vertetuar sikurse është precizuar kjo në kuptim të pikës 1, të dispozitivit të këtij Vendimi.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit e Shqyrtues

Z. Vedat Poterqoi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Gjilan;

1x1 OE- “Teuta M”;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.